KUSH PUNOI MË SHUMË SE ENVERI PËR SHKOLLIMIN E SHQIPTARËVET?!

GJOKË DABAJ

~~~
~~~

arsimin dhe edukatën, Tiranë 1972, f.6. Tani e tutje, për pjesët e marra nga ky libër, do të shënohet vetëm faqja. Gj.D.)

Më 21 shkurt lexojmë: "***Politika jonë arsimore ka konsistuar… me hapë sa më shumë shkolla fillore dhe me inkurajue arsimin sa më shumë në popull***." (f.7)

Më 24 mars 1946 prapë lexojmë: "***Populli ynë ka nevojë… edhe për më shumë kulturë e arsim***." (f.9)

7 korrik 1946: "***Ndërtimi i Shqipërisë së re*** (i shtetit të ri shqiptar, Gj.D.) ***nuk mund të bëhet me njerëz analfabetë, por ka nevojë për njerëz të ditur e të aftë me drejtue degët e ndyshme të ekonomisë.***" (f.11)

"***Duhet me mobilizue popullin për ngritjen e shkollavet në të gjitha anët e Shqipërisë e sidomos në krahinat e Veriut***." (12.)

[Kam dëgjuar e lexuar andej e këndej se Enveri e ka urrejtur Veriun. Madje është thënë që ai ka pasur fobi ndaj veriorëvet. Unë nuk e kam vënë re askund te Enver Hoxha një veti të tillë antikombëtare.] (Gj.D.)

"***Të mos mbetet njeri pa vajtur në shkollë, të luftohet me të gjitha forcat analfabetizmi***." (f.13)

6 mars 1947. "***Pa arsim e pa kulturë nuk mund të ecim përpara. Kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë dhe në radhë të parë për rininë... Gjithë rinia duhet të vejë në shkollë.***" (f.14,15)

„***Ka vështirësi teknike, ka mungesë tekstesh, ka mungesë lokalesh dhe orendish shkollore, ka vështirësi ekonomike për mësuesit, profesorët dhe nxënësit***." (f.15)

„***Të gjithë e dimë se mund të mësohet mirë kur të kemi të gjithë komoditetet, por merita qëndron, dhe këtu shquhen njerëzit e rinj, kur***

ne mësojmë, ndërtojmë, shkojmë përpara edhe përmes vështirësivet të mëdha.“ (f.15)

8 nëntor 1948. „***Socializmi dhe demokracia lindin kulturën më të lartë nga kultura kapitaliste.***“ (f.19)

[Pikërisht këtu do kërkuar edhe arsyeja pse kapitalizmi i restauruar, jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, por edhe në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, bëri e bën çmos për ta denigruar, tjetërsuar dhe asgjësuar kulturën socialiste.] (Gj.D.)

„***Njerëzit e shoqërisë socialiste... duhet të jenë njerëz me kulturë, me ideale të lartë, me kërkesat dhe shijet e larta kulturore dhe morale, duhet të qëndrojnë më lart se njerëzit e qytetërimit borgjez...edhe nga pikëpamja mendore***.“ (f.19)

„***Popullin shqiptar shekuj të tërë e mbanin në errësirë e në padituri, 500 vjet turqit vepronin në Shqipëri sikur të ishin zotër të vendit, duke***

mbjellë ‚kulturën‘ e tyre... Më tepër se 80% e të gjithë popullsisë së Shqipërisë ishte analfabete.“ (f.20)

[Mbas vitit 1990, në Republikën e Shqipërisë dhe në krejt Shqipërinë, u mbollën çoroditja kulturore e arsimore, errësira dhe padituria, me të gjitha mënyrat.] (Gj.D.)

(Shënim i rastit, sa për sqarim: Enver Hoxha e përdor gabim emrin ***Shqipëri*** edhe kur ka kuptimin e shtetit shqiptar të njohur ndërkombëtarisht më 1913-n. Por në fjalinë e mësipërme mund të merret edhe me kuptimin tërësor, sepse Turqia sundoi për pesë shekuj, madje në mjaft vise për më shumë se pesë shekuj, në krejt Shqipërinë ose Arbërinë, siç quhej deri në shekullin XVIII. Gjithsesi, duhet të kemi kujdes kur hasim te emri ***Shqipëri***, sepse edhe Enveri, në shumicën e rastevet, siç kanë vepruar e veprojnë edhe sot shumica e shqiptarëvet, e ka përdorur gabim këtë fjalë, në vend që të thoshte RPSH ose RPSSH. Gj.D.)

„***Sipas një qarkoreje të Ministrisë së Arsimit në vitin 1938, kontrollimi i shkollës i ngarkohej xhandarit analfabet***.“ (f.21)

[Sot, të gjitha shkollat në Republikën e Shqipërisë, ato që nuk janë shembur e shkatërruar dhe në të cilat shkojnë ende nxënës, ruhen me policë. Mjerë ai popull që detyrohet t’i ruajë shkollat me policë të armatosur me kobure!] (Gj.D.)

„***Që nga viti 1920 deri në vitin 1939 në Shqipëri*** (në shtetin shqiptar, Gj.D.) ***ishin shtuar vetëm 190 shkolla fillore. Në vitin 1939 në Shqipëri*** (në shtetin shqiptar, Gj.D.) ***numëroheshin 5 biblioteka me 25 mijë vëllime***.“ (f.21)

„***Shkolla duhet... të luftojë... kundër influencës së huaj mbi fëmijët***.“ (f.23)

[Më poshtë Enveri jep të dhëna statistikore. Arsimi fillor në shtetin shqiptar: Më 1938-n ka 643 shkolla, më1945-n ka 1755 shkolla, më 1948-n ka 1893 shkolla. Në krahasim me 1938-n, për 3 vjet, nga viti i Çlirimit, qeveria e Enver Hoxhës ka hapur 1250 shkolla të reja… Shteti shqiptar, në vitin 1948, kishte 2602 qendra banimi. Prej këtyre, vetëm në 224 qendra ende nuk ishin hapur shkollat…] (Gj.D.)

Në këtë kohë qeveria e Enver Hoxhës kish bërë ndryshime edhe në programet mësimorë. Lidhur me këtë Enveri thotë: "***Duke hequr (lëndët e panevojshme), mësimin e fesë, gjuhën latine, greqishten e vjetër, të ashtuquajturën 'shkencë mbi jetën', i vëmë kujdes të madh të mësuarit thellësisht të gjuhës amëtare (dhe shkencavet të tjera)***." (f.26)

[Në vitin shkollor 1938/1939 qeveria e A.Zogut kish caktuar për arsimin 2 milionë e 735 mijë franga. Në vitin 1946 qeveria e Enver Hoxhës ka shpenzuar për arsimin 47 milionë e 929 mijë franga… Në vitin 1948 qeveria e Enver Hoxhës kish dërguar jashtë vendit, për të studiuar në degë të ndryshme, 815 studentë, ndërsa brenda vendit ish hapur për herë të parë ***Instituti i Lartë Pedagogjik***, me degët: gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, gjeografi, matematikë, fizikë, biologji dhe kimi. Në Tiranë funksiononte shkolla teknike me 488 nxënës, teknikumi financiar ekonomik me 211 nxënës, teknikumi i gjeometravet me 61 nxënës, shkolla artistike muzikore me 111 nxënës, shkolla sportive me 35 nxënës, shkolla mjekësore me 54 nxënës dhe shkolla bijqësore me 230 nxënës. Kish edhe disa shkolla të tjera profesionale me gjithsej 730 nxënës.] (f.23-32)

"***Një rëndësi të jashtzakonshme***", thotë Enver Hoxha, "***ka likuidimi i analfabetizmi dhe arsimimi i të rriturvet***." (f.32)

"***Në vitin 1945/1946 numri i analfabetëvet në moshën 14-40 vjeç ishte afërsisht 317 mijë vetë. Në vitet 1945-1948… (kanë mësuar të shkruajnë e të lexojnë) 109 mijë e 189 vetë.***" (f.32)

"***Përveç kursevet kundër analfabetizmit, u krijuan edhe (shkollat e natës) për të rriturit. Në vitin 1946 këto shkolla i mbaruan (mbi 10 mijë vetë.)***" (f.32)

[Në vitin shkollor 1947/1948 kish 570 shkolla fillore të natës me mbi 21 mijë nxënës, kish 26 shkolla shtatëvjeçare të natës me mbi 2 mijë nxënës… Në vitin 1946 në shtetin shqiptar kish 6 biblioteka me 96 mijë ekzemplarë, ndërsa në vitin 1947 vetëm në fshatra u hapën 72 biblioteka. Në vitin 1948 numri i bibliotekavet u rrit në 373. Pra, nga 6 biblioteka që shteti shqiptar kish trashëguar nga e kaluara, në dy vjet u bënë 373biblioteka!.. Në vitin 1948 në shtetin e ri shqiptar dilnin më shumë se 25 gazeta e revista me një tirazh prej një milion ekzemplarësh… Instituti i Studimevet Shkencorë, i krijuar mbas Çlirimit, në vitin 1948 kish 65 bashkëpunëtorë shkencorë.] (f.32-36)

Më 19 qershor 1950 Enver Hoxha thotë: "***Kur Shqipëria ka nxënës të mirë, e ardhshmja e popullit tonë është më e sigurt.***" (f.40) "***Dituria është stoli e nevojshme për njeriun***." (f.42)

Më 29 qershor 1952 Enveri ngre prapë problemin e arsimimit të punëtorëvet dhe thotë: "***Është e dënueshme të mos tregohet një kujdes i jashtzakonshëm… për punëtorët e rinj që deri dje s'dinin të shkruanin e të lexonin***." Pastaj shtron pyetjen: "***A është e lejueshme të mendojmë vetëm për realizimin e planit dhe të mos mendojmë njëkohësisht për edukimin sa më të plotë të punëtorëvet***?" Dhe përgjigjet: "***Kurrsesi s'është e lejueshme***!" (f.56-57)

Më 22 gusht 1952 Enveri flet për problemin e të mësuarit paralel me punën. „***Të gjithë ata që janë në punë, interesi i Partisë është që të***

vazhdojnë edhe shkollën, pse situata nuk na lejon që të mbarojnë të gjithë shkollën e pastaj të futen në punë, por të punojnë dhe njëkohësisht të mësojnë: të arrijmë që këta njerëz që futen në shkollat e mbrëmjes dhe me korrespondencë, të mbarojnë qind për qind shkollat." (f.59-60)

Më 12 prill 1954, në Gjiokastër, Enver Hoxha do të kujtonte mësuesit e vet të dikurshëm: "***Me respekt kujtoj sot mësuesit e vjetër patriotë që… na mësonin me guxim të shkruanim dhe të këndonim gjuhën tonë të ëmbël amëtare, na mësonin historinë e lashtë heroike të popullit, na mësonin të urrenim dhe të luftonim okupatorët dhe tradhtarët e vendit tonë***." (f.61)

[Sot, 27 vjet mbas përmbysjes së pushtetit progresist të Enverit, ndër shqiptarët është mbjellë një konfuzion i tmerrshëm lajthitës midis koncepteve ***TRADHTAR*** e ***ATDHETAR*** dhe pastaj është arritur deri aty, sa është shtruar dilema: ***A duhen luftuar apo nuk duhen luftuar tradhtarët***?! Njerëzit nuk dinë ç'të bbëjnë, sepse nuk dinë kush është tradhtar e kush nuk është tradhtar.] (Gj.D.)

"***Mësoni me të gjitha forcat tuaja, pse atdheu ka shumë nevojë për njerëz të mësuar***!" Kështu thotë Enver Hoxha dhe kjo është e vetmja mënyrë për ta mundur errësirën.(f.62)

Në Kongresin III të PPSH-së, në vitin 1956, Enveri njofton se "***në të gjitha kategoritë e shkollavet tona (aktualisht) mësojnë mbi 189 mijë nxënës e studentë***" dhe shpall planin e zhvillimit të mëkëndejshëm të arsimit: Në vitin 1960, në shkollat fillore, shtatëvjeçare e të mesme, do të mësonin jo më pak se 249 mijë nxënës, kurse numri i studentëvet do të arrinte në 3 mijë vetë. Në shkollat profesionale dhe në institutet e lartë do të përgatiteshin rreth 6200 teknikë të mesëm dhe reth 2300 specialistë të lartë. (f.64, 65)

Në 40-vjetorin e gjimnazit të Shkodrës, më 16 dhjetor 1962, Enveri thotë: „***Juve, të rinjvet e të rejavet, ju janë hapur të gjitha mundësitë për dituri dhe shkencë, prandaj kurdoherë duhet të bëni përpjekje sa më të mëdha për të mësuar mirë në shkollë… Të mësosh mirë gjuhën tënde, ta shkruash bukur atë, kjo është një nga detyrat kryesore për të gjithë ne, veçanërisht për ju, brezin e ri.***" (f.83)

[Sot, mjerisht, gazetarët tanë nuk dinë të dallojnë as trajtën e shkurtër *U* (*atyre u*) nga trajta e shurtër *I* (*atij i*)!] (Gj.D.)

Në 40-vjetorin e shkollës 12-vjeçare "***Qemal Stafa***", 29 dhjetor 1965, Enveri, si gjithnjë, foli gjërë e gajtë për të gjitha çështjet që lidheshin me arsimin: "***Ju të rinj e të reja e doni shumë shkollën. Por besomëni se atë e duam fort edhe ne që jemi më të vjetër. Sa më shumë plakemi, aq më shumë ndizet në gjirin tonë dashuria për shkollën… Burokracia është një sëmundje e tmerrshme… ua ka lidhur duart mësuesvet dhe profesorëvet tanë… e kanë kronometrizuar orën e mësimit duke e futur atë në kallëpe të tillë që të ngrihet lesht e kokës… Por ju, mësues e profesorë, nxënësvet duhet t'u jepni ajkën, t'u jepni atyre çdo gjë në përshtatje me moshën dhe me lëndët e tjera që nxënësi merr në shkollë… Kurrë nuk duhet t'u prishet qejfi fëmijëvet, natyrisht jo në kuptimin që ata t'i lejosh të të hipin në kokë… Kultura fizike, gjimnastika, duhet të jetë një nga lëndët e rëndësishme në programet shkollorë… Kur njeriu është akoma i ri, duhet të mësohet me punë dhe me mësim… Rinia duhet të rritet edhe si trimëreshë, edhe me iniciativë, t'i pjellë mendja, të mos jetë automate.***" (f. 96, 98, 101, 103, 104, 106, 107)

Më 20 shtator 1966, në bisedë me aksionistët, Enveri këshillon: "***Krahas mësimit… ju duhet të mësoni edhe… ç'do të thotë punë, përpjekje, mundim, djersë dhe fitore… Ne kemi një rini shumë të zgjuar, të vendosur, heroike, të ndershme, por duam që ajo të jetë edhe e rrahur***

me vaj e me uthull… Bashkë me mësimin është i nevojshëm edhe aksioni, është e domosdoshme edhe puna, pse kështu çdo gjë do ta kuptoni më mirë… Nxënësi duhet ta dojë mësuesin, të afrohet me të, por nxënësi duhet edhe ta ndihmojë mësuesin, ashtu si edhe mësuesi e ndihmon nxënësin." (f.113-124)

"***Të thellojmë frymën revolucionare në arsim!***" Ky është titulli i një elaborati të madh që e lansoi Enver Hoxha, filluar nga 1969-a e këndej.

[Shkolla është institucioni që përgatit profesionistë, thënë orientalisht, ***zanatçinj***. Po "***zanatin***" për të qenë njeri i saktë, "***profesionin***" për t'u bërë njeri i mirë, cili institucion ia jep njeriut? Duke qenë se shkolla ka edhe komponentin e edukimit, komunistët menduan që pikërisht në shkollë (dhe pastaj në pjesën tjetër të jetës jashtë shkollës), duhej "***krijuar***" "***njeriu i ri***", ai që do të duhej ta çonte njerëzimin në një sistem shoqëror "***pa klasa***". Pikërisht këtu duket se gabuan komunistët. Shkolla ish vendi ku njeriu edhe edukohej, por shkolla nuk sundonte mbi njeriun. Njeriu ka nevojë të sundohet ideologjikisht, punë që në sistemet e mëparshëm shoqërorë, e kishin kryer dhe e kryenin religjionet. Komunistët nuk i hynë punës për të krijuar një religjion të vetin, një institucion ideologjik, me një teori, të cilën deri diku e kishin, me një qendër udhëheqëse dhe me faltoret përkatëse. (Fjalën ***FALTORE*** nuk po e vë nën thonjëza, sepse komunistët, nëse donin ***NJË NJERI NDRYSHE***, vërtet duhej t'i krijonin atij njeriu edhe FALTOREN ku ai të shkonte PËR T'U FALUR.) Kjo ish një mënyrë që njerëzimi e kish praktikuar prej mijëra vjetësh dhe që komunistët nuk ditën ta adaptonin.](Gj.D.)

Gjihsesi përpjekjet ishin pozitive dhe Enver Hoxha punoi shumë që shkolla ta luante rolin që duhej në krijimin e "***NJERIUT TË RI***".

Në kuadër të këtij vizioni madhor ai thotë: "***Duhet të pranojmë se në fushën e metodavet të mësimit dhe të edukimit shkolla jonë është akoma prapa. Në shkollë ka akoma shumë formalizëm, pasivitet tek nxënësit dhe ndrydhje të personalitetit të tyre***." (f.134) …Dhe pastaj vazhdon: "***Jeta është shkollë… Puna mendore është e pazgjidhshme nga puna praktike… Materia është primare dhe mendimi sekondar.***" (f.153) Postulate që ishin formuluar me kohë në filozofinë e materializmit dialektik dhe që Enveri mundohej t'i vinte në jetë.

„***Të gjithë pa përjashtim duhet të mësojmë të edukohemi gjatë gjithë jetës... Edukimi i pandërprerë gjatë gjithë jetës së njeriut, është një çështje me shumë rëndësi***." (f.154)

Mirëpo, vizioni madhor i Enver Hoxhës, dashur pa dashur, kalon në utopi: „***Mësimi dhe edukata në shkolla nuk mund të konsiderohen, siç i konsideron filozofia borgjeze, si një mjet spekullimi dhe përfitimi personal***." (f.164) Parimi është ai që duhej, por mekanizmi për ta realizuar atë parim madhor, mungonte dhe për këtë sigurisht që nuk mund të fajsohet Enver Hoxha. Mekanizmi nuk ekzistonte. Ai duhej krijuar, por komunizmi në shkallë botërore tashmë kish marrë tatëpjetën.

„***Dyert e universitetit nuk janë të mbyllura për kërkënd, por ata që do ta ndjekin këtë, duhet të kenë arsimin përkatës dhe këtë përcaktim ne duhet ta bëjmë mirë... Në një rast të mëvonshëm kërkesat ndaj atyre që do të ndjekin arsimin e lartë, do të jenë më të shtërnguara***." (f.167)

[Unë isha kundër kësaj teze dhe ia shpreha këtë kundërshtim Enver Hoxhës në librin që i dërgova në vitin 1982 dhe që është përfshirë tashmë në kuadër të këtyre parashtrimeve. Unë, pra, isha për të mos e kufizuar arsimin e lartë, as për ta „***shtërnguar***" atë, por që, inteligjenca, e krijuar prej shkollimit masiv, të ndahej në ***inteligjencë udhëheqëse*** dhe në ***inteligjencë zbatuese***. Inteligjenca udhëheqëse ta udhëhiqte shoqërinë

nga pozitat e klasës punëtore, duke qenë vetë praktikisht pjesë e asaj klase.] (Gj.D.)

Në faqet 178-179 Enveri flet me hollësi lidhur me qëndrimin që duhet të mbajë njeriu i sotëm ndaj ***Rilindjes Evropiane*** të shekullit XV dhe ndaj ***Rilindjes Kombëtare Shqiptare*** të shekullit XIX. Ai i vlerëson të dyja këto periudha, por, natyrisht, mban edhe qëndrim kritik ndaj disa veçorive të tyre.

Kur flet për literaturën që duhet të përkthehet e të botohet në shqip, ai thotë kështu: „***Popullit dhe brezit të ri... duhet t'i japim në duar libra jo për t'i çorientuar dhe çoroditur shpirtërisht, po për t'i ndihmuar të njohin zhvillimin e shoqërisë***." (f.182)

[Kapitalizmi mezi priti të shqyhen dyert e RPSSH-së, që këtu të futen libra, këngë, filma dhe teatro, për t'i bërë çorap mendjen dhe shpirtin e shimicës së shqiptarëvet.] (Gj.D.)

„***Mësimi dhe puna, shkolla dhe jeta duhet të lidhen ngushtë që në moshë të re***." (f.211)

[...30 vjet më vonë, puna fizike u përjashtua tërësisht nga sistemi i edukimit, ndërsa „***mësimi***", i cili fare lirisht mund të vihet nën thonjëza, iu nënshtrua spekullimevet, si nga ana e profesoratit, ashtu edhe nga ana e nxënësvet dhe studentëvet.] (Gj.D.)

„***Në shkollën tonë i gjithë mësimi, si kultura e përgjithshme, ashtu edhe ajo teknike e profesionale, duhet të lidhen ngushtë me punën prodhuese***." (f.216)

[As ajo rini dhe as mosha më e rritur, nuk deshën ta kuptojë Enverin dhe... i mbushën anijet, i mbushën burgjet, i mbushën kuplaratë dhe e pluhurosën krejt shoqërinë shqiptare me hashash e me marihuanë.] (Gj.D.)

„***Fol, Enver, të lumtë goja!***“, i thoshim atëherë, tani i themi: ***Fol sa të duash, o Enver, se rininë e morri përroi!*** (Gj.D.)

[Më 4 shkurt 1969 Enveri i shkruan letër mësueses Athina Mile, që ish nga Përmeti, martuar me një mirditor në Orosh. (f.229-236) Ai e merr shembullin e saj si një rast të shkëlqyer, se si duhet t'i zgjidhë njeriu problemet e jetës së vet në harmoni me interesat e Atdheut. E merr atë shembull, sepse edhe atëherë kish vajza e djem, të cilët, tërhequr nga botëkuptime të gabuar, nuk dinin t'i zgjidhnin si duhej problemet e jetës. Ndërsa sot ka me mijëra të reja e të rinj shqiptarë, mbetur si mos më keq, në pikë të hallit, pikërisht sepse nuk denjuan t'i pranojnë këshillat e udhëzimet e Enver Hoxhës.] (Gj.D.)

[Te shkrimi "***Në çdo punë të zbatojmë një metodë dhe stil leninist revolucionar***", Enver Hoxha ka shpalosur prapë vizionin e tij në lidhje me kombinimin, edhe në programet shkollorë, të mësimit me punën. Mbështetur edhe në thesarin teorik që kishin krijuar Lenini dhe Stalini mbi kombinimin e teorisë me praktikën, Enveri bëri përpjekje që ta vërë në jetë atë thesar gjithnjerëzor pikërisht në Shqipëri. Por nuk ia doli, sepse krejt përpjekja për ta futur njerëzimin në udhën e progresit, tashmë kish rrëshqitur.] (Gj.D.)

"***Shkolla jonë lufton***", thotë Enveri, "***në parim dhe në praktikë, për atë edukim të plotë që rekomandon Marksi, domethënë për edukatën politeknike, e cila duhet të vërë në dispozicion të njerëzvet kulturën proletare të kohës***." (f.247)

[Më 23 nëntor 1969 Enveri bën një vizitë në ***Shtëpinë e Fëmijës "8 Nëntori"*** (f.258-270) Aty rriteshin, edukoheshin dhe shkolloheshin fëmijët që, në rrethana të ndryshme dhe për shkaqe të ndryshëm, kishin mbetur jetimë. Janë edhe sot dëshmitarë njerëzit që janë rritur nëpër jetimoret që i kish krijuar Enver Hoxha në disa nga qytetet e RPSH-së,

më vonë RPSSH. Atje bëhej çdo gjë, që jeta e atyre fëmijëve të ish sa më e këndshme. Popullit, në vitet e parë mbas Luftës, i mungonte buka, por atyre s'u mungonte asgjë nga ushqimet dhe nga kushtet e banimit. E pashë dhe e dëgjova një natë një emision shumë të bukur mendjefreskues, plot me vërtetësi, ku i shpalosën kujtimet e vet disa nga fëmijët e asaj kohe, sot njerëz të nderuar.] (Gj.D.)

[Njeriut të sotëm i vjen të ulurijë kur i shikon, në vendet ku ngadalësohet trafiku, dhjetëra fëmijë që lypin lëmoshë. Ku është kujdesi shtetëror për këta fëmijë?! Pa le, ata që u mbytën e po mbyten nëpër detra dhe ata që po trafikohen në mënyrën më çnjerëzore! Puna ka arritur deri aty, sa të joshen këtu, në RPSSH-në e dikurshme, MONSTRA PEDOFILËSH dhe të bëjnë skandal me jetimët e këtij vendi!] (Gj.D.)

Më 28 Nëntor 1969, në 25-vjetorin e çlirimit të RPSSH-së, Enveri midis tjerash, flet sërish edhe për "***krijimin e NJERIUT TË RI me veti të larta revolucionare***". Në atë proces transformimi, natyrshëm kish rolin e vet edhe sistemi shkollor, i krijuar në këtë vend në harkun kohor prej 25 vjetësh.

"***Gjithë Shqipëria*** (shteti shqiptar, Gj.D.) ***është mbushur nga një rrjet i gjërë shkollash të shumëllojta …Në çdo 7 vetë 2 mësojnë. Është realizuar plotësisht arsimi i detyruar tetëvjeçar jo vetëm në qytet, por edhe në të gjithë fshatrat. Kjo ndodh në një kohë kur akoma sot në Itali mbeten analfabetë mbi 100 mijë fëmijë në çdo vit, ndërsa në Jugosllavi 20 përqind e popullsisë dhe në Greqi 27 përqind është analfabete ...Në të gjithë sistemin tonë arsimor tani shërbejnë rreth 23 mijë arsimtarë, nga afro 1700 që kishte para Çlirimit***." (f.273) [Për atë që dëshiron ta shohë dallimin, dallimi është krejt i dukshëm.] (Gj.D.)

"***Përsa i përket arsimit të lartë, i cili më parë nuk ekzistonte fare, ne kemi sot 113 studentë në çdo 10 mijë banorë, duke lënë prapa në këtë***

fushë vende të tillë të zhvilluar si Anglia, Gjermania, Italia e Zvicra." (f.274)

„***Sot kemi 1750 shtëpi e vatra kulture, rrjeti i kinemavet është shtrirë jo vetëm në të gjithë qytetet e mëdhenj e të vegjël, por edhe në shumë kooperativa bujqësore. 25 teatro e estrada profesioniste, dhjetëra biblioteka shtetërore, muzeume e shtëpi muze, ndihmojnë për edukimin kulturor e revolucionar të masavet***." (f.274-275)

[Kështu ndodhte në vitin 1969, në kohën e Enverit. Po në vitin 2017, duke pasur në çdo familje televizor, duke pasur një shumicë banorësh telefona celularë, me përjashtim të asaj pjese të popullit që s'ka as shtëpi, as bukë e që ***Topçenëlli*** e të tjerë televizione na i tregojnë çdo natë, sa ndihmojnë këta mjete në edukimin e popullit tonë për së mbari?! …Ah, po! E kemi ***Bigbradherin*** që ndihmon shumë në edukimin kulturor të masavet dhe kemi sistemin e llotarivet dhe të lojëravet të fatit, të cilat, "***me kulturë të madhe***" dhe me "***rregull të përsosur***", i bëjnë "***të lumtura***" mijëra familje shqiptare!] (Gj.D.)

"***Gjatë vitit 1968 vetëm nga Ndërmarrja e Shtypshkronjavet 'Mihal Duri' u botuan 590 libra me një tirazh të përgjithshëm prej afro 7 milionë ekzemplarësh***." (f.275)

[Në vitet 1990 deri më 2017 në Republikën e Shqipërisë, proporcionalisht, janë botuar libra shumë më tepër se në vitin 1968 dhe në vite të tjerë të kohës së Enverit. Por çfarë librash u janë servirur shqiptarëvet mbas vitit 1990?! Po përmend si "***shembul klasik***" vetëm njërin prej tyre: librin "***Vrima***" të autores Ritë Petroja, tashmë të famshme edhe si kryeredaktuese e dhjetëra libravet shkollorë të leximit dhe të gjuhës shqipe. Blijeni dhe lexojeni librin "***Vrima***" dhe jam i bindur që shumica prej jush do të thotë: ***Mjerë 'leximi' dhe 'gjuha shqipe', në dorë të kujt kanë rënë***!] (Gj.D.)

Nën titullin "***Të gjallërojmë më tepër jetën e organizatavet të rinisë në shkolla***", 13 maj 1970, Enver Hoxha konsideron që e ardhshmja e vendit varet shumë nga mënyra si do të edukohen të rinjtë e sidomos studentët.

"***Studentët janë kuadrot e ardhshëm për sektorë të ndryshëm të aktivitetevet shoqërorë, ekonomikë, arsimorë, kulturorë etj… (Prandaj) çështja e edukimit ideo-politik të rinisë dhe në veçanti e studentëvet, ka një rëndësi të jashtzakonshme për formimin e ndërgjegjes proletare dhe të pikëpamjevet të tyre filozofike***." (f.278-279)

[Dhe vërtet ashtu ndodhi: Me mijëra kuadro u përgatitën dhe punuan me përkushtim të madh në të mirë të Atdheut! Por ata i preu dhe i thau restaurimi, siç preu edhe pyjet anembanë RPSSH-së. Një pjesë i eksportoi, për të shkëlqyer në të gjitha fushat, jashtë Atdheut, një pjesë tjetër i detyroi të heshtin dhe i rrëgjoi siç rrëgjohen filizat e fidanëvet, kur i përvëlon thatësira!] (Gj.D.)

PJESË E NDËRMJETME (INTERMEXO)

Një mbesë e një ish të persekutuari ka sjellë nga Italia veprën "***Rrno vetëm për me tregue***" të Atë Zef Pllumit (titullin e së cilës e kam përdorur unë në formën e kundërargumentit), dhe e ka shpërndarë falas midis nxënësvet të një gjimnazi në Tiranë. Iu bë edhe një intervistë në njërin prej televizionevet, në të cilën kërkesa kryesore e saj ishte: "***TË DALË E VËRTETA***".

Epo mirë! Le të dalë e vërteta! Në thelbin e çështjes edhe unë atë punë po bëj. PO JAP KONTRIBUTIN TIM PËR TË NXJERRË NË SHESH TË VËRTETËN. Veçse ka disa dallime midis meje dhe mbesës së atyre ish të pesekutuarve. Ajo po flet sot në kushte të favorshëm, sepse puna patriotike e Enver Hoxhës është stigmatizuar, sulmuar dhe mohuar nga të katër anët. Është lehtë sot të flasësh kundër Enver Hoxhës, kur

pushteti i tij është rrëzuar dhe çdo gjë e mirë që ndërtoi ai pushtet, është rrënuar. Ashtu siç ish atëherë vështirë të flisje kundër Enver Hoxhës, ashtu është sot vështirë të flasësh në përkrahje të Enver Hoxhës.

Veç kësaj, e shoh të nevojshme të vë në dukje që zonja në fjalë nuk ka ndenjur këtu në Shqipëri, për ta ndërtuar Shqipërinë ashtu siç thotë se donte ajo dhe siç thuhet se donin të parët e saj të persekutuar. Dhe unë tani po shtroj këto pyetje: Pse nuk qëndroi këtu kjo zonjë, për ta ndërtuar Shqipërinë ashtu siç thuhet se e donin të parët e saj dhe ajo vetë?! Ç'bëri ajo në këta 27 vjet, psh për zhvillimin e arsimit e kulturës në brezin e ri të shqiptarëvet? Apo u mjaftua duke i dhuruar atij brezi një libër "***mbi të vërtetat***" e asaj kohe?!

Çfarë ndërtoi ajo, qoftë edhe në fshatin apo qytetin e saj?!

Ajo është një grua e re, e cila, në vitet e ***Luftës së Kosovës*** duhet të ketë qenë 20-vjeçe. Përse nuk shkoi në atë luftë, për të dhënë kontributin e vet për çlirimin edhe të asaj pjese të Atdheut, por shkoi në Itali?! Sa, nga ajo klasë e ish të persekutuarvet, morën pjesë në përpjekjen për të çliruar Kosovën, Luginën e Preshevës apo në luftën e shqiptarëvet për të drejtat e veta në të quajturën *IRJM*?! Le ta shkruajë një libër me këtë temë zonja në fjalë, e cila po kërkon me kaq përkushtim ***TË DALË E VËRTETA*** dhe që po i përdor vazhdimisht fjalët ***Komb e Atdhe***!

Por, ata ish të persekutuar, janë mjaftuar duke kërkuar "***dëmshpërblimet***" dhe duke shkruar nga një libër, mbushur mllefe e mallkime ndaj regjimit që i ka persekutuar! Kjo është E VËRTETA dhe mua tash më lind e drejta të pyes: A bënë mirë ata, kur e kundërshtuan atë regjim dhe ndodhën mbi vete persekutimin, kur s'e kishin as mendësinë, as mundësinë për ta përmirësuar gjendjen e popullit shqiptar?! (Nuk po e vë nën thonjëza fjalën ***persekutim***, sepse nuk do të ish e sjellshme nga ana ime.)

Po në fushën e arsimit ç'punë të mirë ka bërë kasta apo klasa e zonjës që flet me aq urrejtje kundër Enver Hoxhës?! A mund të mburret, koha që ajo e dëshiroi aq shumë, dmth koha e sotme, me 40 mijë diploma falso, që janë shpërndarë nëpër shqiptarët në këtë çerek shekulli?!

Do të mund të bënim edhe pyetjen: Pse lejoi ajo kastë apo klasë që në këtë shtet të shkatërohej ekonomia, në një kohë kur mund të përfitonte edhe ajo jo pak prej asaj ekonomie në procesin e privatizimit?! Por meqë jemi në sferën e arsimit, po ndalemi edhe pak vetëm këtu: A mendon zonja që një mori universitetesh privatë në Republikën e Shqipërisë, po edhe në vise të tjerë të Shqipërisë, kanë sjellë progres në Kombin tonë?!

Dhe përfundimisht, urrejtja ndaj regjimit të Enver Hoxhës, servirja e të gjithë atyre fakteve (për të cilët nuk po dua të shfaq dyshime), a ka vlera përgjithësuese apo janë reagime thjeshtë personalë, familjarë ose edhe gruporë, por që s'kanë të bëjnë me të mirat që ai regjim i ka sjellë këtij Kombi?! Apo mos kemi të bëjmë këtu me atë sentencën: ***Kur digjet lëkura ime, gjithë planeti digjet***!? Sepse, të mos ish kështu, në atë librin "***Rrno vetëm për me tregue***" do të ish thënë ndonjë fjalë edhe për punët e mira që ka bërë Enver Hoxha.

Gjithsesi (këtë mendim e kam shprehur edhe në hyrje të librit "***Rrnoj edhe unë për me tregue***"), nuk do të ish keq që, po ata nxënës gjimnazi që e morën dhe mendohet se po e lexojnë librin e Atë Zef Pllumit, ta marrin e ta lexojnë edhe librin tim. Ta lexojnë se, siç po shikohet në këta citime nga vepra e Enverit dhe që nuk mund të hidhen poshtë, Enver Hoxha nuk paska qenë aq kriminel, sa ç'e paraqesin njerëz të persekutuar si Atë Zef Pllumi, apo edhe siç po kërkon ta paraqesë, krahas dhjetëra të tjerëve, edhe kjo zonja!

FUNDI I PJESËS SË NDËRMJETME

Më 24 mars 1971 Enver Hoxha mban një fjalim mbi përsosjen e figurës morale të rinisë. Ai thotë: "***Detyra jonë është të luftojmë për ta mbrojtur rininë nga helmi i ideologjisë borgjeze e revizioniste. Luftimi i vesevet të këqinj është një çështje, së cilës duhet t'i kushtojmë kujdesin e duhur***." (f.300)

[Ishte viti 1971. Enver Hoxha tashmë kish filluar të shqetësohej shumë për të ardhshmen e vendit dhe kërkon rrugë e mundësi për t'u bërë ballë dukurivet negative. Flet për filmat e importuar që duhet të kenë frymë përparimtare, jep udhëzime për leximin e diskutimin e libravet, për sjelljet e tifozëvet në fushat sportive, për mënyrën e veshjes.] (Gj.D.)

„***Në rini, në vend që të zhvillohet tifozllëku, le të zhvillohen të gjithë llojet e sportit, ku të rinjtë e të rejat të marrin pjesë më gjërësisht***." (f.302) [Sot po rrihen e po grihen tifozët nëpër stadiume. Sot po zbrazin xhepat e mijëra familjeve bastet sportivë…Cila kohë është më e mirë?!] (Gj.D.)

„***Duke kërkuar të jenë ‚origjinalë' në veshje, në mbajtjen e flokëvet etj, bëhen qesharakë***," ka thënë Enver Hoxha. (f.302) [Sot janë të lirë e të lira të bëjnë ç'të duan me veshjen, me flokët dhe me mjekrën. Megjithatë, edhe ne jemi të lirë të pyesim: Të lirë apo SKLLEVËR TË MODAVET janë këta të rinj e të reja të sotme?!] (Gj.D.)

Pasi i ka bërë një varg vërejtjesh, Enveri konkludon si përherë me një frymë optimizmi: "***Rininë e kemi të pastër, megjithate, duhet ta edukojmë vazhdimisht me kujdes, para së gjithash duke e bindur.***" (f.310)

[Ç'mund të bënte tjetër udhëheqësi i një populli të rrethuar nga të gjitha anët me trysni ultimative: ***O bëhuni si ne, o vdisni në izolim të plotë***?! …S'pushon propaganda së bërtituri: ***Enver Hoxha e izoloi Shqipërinë***! Por është e kundërta: Kapitalizmi na kish izoluar ne me të gjitha

mënyrat, deri sa ia arriti që në Tiranë të ketë edhe SEKS KOLEKTIV! Bujqësinë kolektive nuk e pëlqenin. Ndërsa SEKSIN KOLEKTIV, një femër me tre burra përnjëheresh, e pëlqejnë!] (Gj.D.)

Në një rast tjetër, më 29 shtator 1971, shohim që Enveri është i shqetësuar, sepse njerëzit nuk lexonin dhe nuk studionin. Si mund të ecnin industria dhe teknologjia përpara, pa lexuar e pa studiuar?! „***Ka njerëz... që... lënë t'u kalojë koha e lirë me llafe të kota, në vend që t'i caktojnë vetes detyra studimi***.“ (f.329)

[Po kujt t'i flasësh?! Murit?! Jo vetëm studimin, por edhe punën, njerëzit e paformuar, tashmë të ngopur me bukë, po e neglizhonin. Po merrnin rrogat pa punuar!] (Gj.D.)

“***Shumë njerëz***,” thotë Enver Hoxha, “***mendojnë se, duke qenë në rendin socialist, jo vetëm 8-orëshin e detyruar mund të mos e plotësojnë… por edhe ligjin mund ta thyejnë e të punojnë më pak.***” (f.329)

[Duke lexuar këta rreshta, gjithkush mund ta kuptojë revoltën që Enver Hoxha e manifestoi ndaj udhëheqësvet përgjegjës për gjendjen. Sëmundja ish kanceroze, Enver Hoxha do të mundohej të operonte tumoret, por metastazat mbeteshin të paprekura.] (Gj.D.)

26 maj 1972: “***T'u japim studentëvet të mjekësisë njohuri të plota e serioze për profesionin e tyre, …se në këtë fushë nuk është njësoj si me prodhimin e artikujvet industrialë të konsumit të gjërë, si të këpucëvet, stofavet, enëvet etj, të cilët, edhe në rast se nuk dalin aq të mirë, fundi i fundit, mund t'i hedhim në treg me një çmim më të lirë ose mund t'i zëvendësojmë. Kurse një mungesë përgatitjeje e shëndoshë e me seriozitet të madh e kuadrovet në shëndetësi, përbën një problem të rëndësishëm që na kushton shtrenjtë, se jeta e njerëzvet nuk mund të krahasohet me asgjë***.” (Vep.49, f.83)

[Sot, për fatin tonë të keq, ke frikë të shkosh në spital, sepse, nga një anë ia than kuletën familjes, nga ana tjetër, të shtohet sëmundja. Populli, veçanërisht pjesa fshatare, „***mjekohet***“ me ilaçe të skaduar. Fakulteti i mjekësisë ka kohë që nuk nxjerr më mjekë, por, ose antimjekë, ose një lloj bluzabardhësh krejt të paaftë.] (Gj.D.)

Më 15 qershor 1972: “***Edhe unë, si gjithë shokët, mendoj se ka ardhur koha të krijojmë (Akademinë) këtë institucion me rëndësi, pse e kërkon nevoja që shkencat tona të ngrihen në një nivel akoma më të lartë***! (Vep.49, f.161)

Më 25 nëntor 1972 Enveri i thërret në KQ të PPSH-së njerëzit që do ta drejtonin Akademinë e Shkencavet të RPSSH-së dhe bisedon me ta hollësisht si do të veprohej. Në bisedë marrin pjesë Aleks Buda, Kolë Popa etj dhe vendoset që Kryetar i Akademisë të jetë Aleks Buda, nënkryetarë Kolë Popa dhe Petrit Radovicvka, ndërsa Bedri Dedja sekretar.

Më 24 maj 1972 Enveri këshillon që kultura dhe njohuritë të hyjnë sistematikisht në familje. “***Ne kemi shumë shkolla, duke filluar nga më të ulëtat e deri te më të lartat, …por duhet të bëjmë përpjekje edhe për zhvillimin kulturor të brezavet më të rritur… Është e domosdoshme të gjejmë forma e metoda pune që arsimi, dhe sidomos kultura, në mënyrë të koncentruar, të futen thellë në familje, veçanërisht në gratë***.” (Vep.49, f.56)

[Është tashmë e qarë: Duhej një INSTITUCION AFATGJATË, me predikatoret e veta të përhershme, ngjashëm nga forma me kishat e xhamitë, por të ndryshme në përmbajtje, ku të kultivoheshin qëndrueshëm cilësitë pozitive njerëzore dhe ku të luftoheshin cilësitë negative!] (Gj.D.)

Më 15 qershor 1972 Enver Hoxha vë në dukje edhe përgjegjësinë që ka familja për edukimin e fëmijës, edhe përgjegjësinë që ka shkolla. (Vep. 49, f.168,169)

Më 21 shtator 1972 Enveri thotë: "***Pse të mos venë në Fierzë pedagogët për të mësuar dhe për të edukuar punëtorët e këtij kantieri të madh? Kjo mungesë gatishmerie, më duket mua, vjen më shumë sepse nuk punohet siç duhet politikisht me njerëzit, prandaj edhe atyre nuk u pëlqen të shkojnë***." (Vep.49, f.366)

Më 28 tetor 1972: "***Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ta kuptojë mirë rëndësinë e madhe të fizkulturës për të tashmen dhe për të ardhmen e brezavet të Shqipërisë, ...për të vënë disiplinë të rreptë në këtë lëndë të rëndësishme mësimore. Për këtë qëllim duhen sigurisht edhe mësues***." (Vep.49, f.416)

Më 28 Nëntor 1972, në pritjen që organizohet me rastin e festavet, ai thotë: „***Arsimi është bërë si buka për popullin tonë. Kudo, s'ka fshat, s'ka qytet, s'ka fabrikë, s'ka repart pa shkolla të llojeve të ndryshëm. Shkolla, shkolla dhe dritë kudo për mendjet dhe zemrat e njerëzvet tanë***." (Vep. 49, f.519)

Më 10 janar 1973 diskutohet hollësisht për titujt dhe gradat shkencore të anëtarëvet të Akademisë. (Vep.50, f.16-20)

Më 25 janar 1973 bëhet mbledhja e parë me anëtarët dhe anëtarët korrespondentë të Akademisë së Shkencavet. Enver Hoxha merr pjesë aty dhe i uron punë të mbarë Akadeisë: "***E ngre këtë dolli për ju, shokë të shquar akademikë të parë të vendit tonë. Ju uroj jetë të gjatë dhe suksese në punë për të mirën e popullit, për të mirën dhe përparimin e shkencës sonë, e cila, …jo vetëm afirmohet në vend, por edhe jashtë, sidomos në disa drejtime***." (Vep.50, f.136)

Më 11 prill 1973, në një mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH-së Enveri, duke trajtuar temën e revolucionit tekniko-shkencor, do të thotë kështu: "***Sa i përket zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor, drejt janë përcaktuar rëndësia dhe roli i Akademisë së Shkencavet, por nuk janë vetëm Akademia me institutet e saj vartës që do ta zhvillojnë këtë revolucion. Këtë ta kuptojmë mirë, se ka edhe do të ketë institute të tjerë që, megjithëse nuk janë të varur organikisht prej Akademisë, do të marrin pjesë gjallërisht në zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor në shërbim të realizimit të planevet tanë ekonomiko-shoqërorë.***" (Vep.50, f.399)

[Mbas restaurimit, një nga „***punët***" kryesore të rrënuesvet të shtetit shqiptar ka qenë rrënimi i Akademisë.] (Gj.D.)

[Enver Hoxha ka folur shumë herë gjërësisht për të quajturin ***revolucion tekniko-shkencor***. Për këtë do të mund dhe do të duheshin bërë studime krahasues midis faktorëvet që e shtyjnë teknologjinë kapitaliste të përsoset dhe kërkesës këmbëngulëse të udhëheqësvet komunistë për një revolucion tekniko-shkencor. Ku e çojnë njerëzimin e quajtura ekonomi e tregut dhe gara për ta sofistikuar procesin e prodhimit? Në anë tjetër, deri ku, deri në ç'shkallë arritën t'i përparojnë shkencën, ekonominë, të quajturat ***lëvizje stakanoviste***?] (Gj.D.)

19 janar 1973. Duke folur për ushtrinë, Enver Hoxha thotë se „***edukimi ushtarak i rinisë shkollore është pjesë e edukimit të saj të përgjithshëm***." (Vep.50, f.64)

[Shkelja, nëpërkëmbja e këtij parimi përjetësisht të domosdoshëm, i ka vënë ferrën çdo mundësie për t'u mbrojtur Kombi ynë prej çdo lloj agresioni. 25 vjet mbas restaurimit të kapitalizmit, në Shqipëri mund të vijë kush të dojë dhe t'i therë si delet fëmijët dhe gratë tona.] (Gj.D.)

22 janar 1973: "***Në punën prodhuese nxënësit e studentët kaliten, por edhe mësojnë një profesion***." Ky është titulli i një diskutimi që bën Enveri në Byronë Politike… "***Nëpërmjet punës prodhuese ka dobi edhe prodhimi, edhe njeriu …(Por) normat e punës, sidomos për nxënësit e shkollavet të mesme, nuk duhet të jenë të larta, se ata janë filiza të rinj dhe, po të ngarkohen me norma të rënda, do t'u dëmtohet shëndeti***." (V ep.50, f.101)

[Na flasin për tortura në burgje, për internime dhe për keqtrajtim të gravet dhe fëmijëvet nëpër kampet e të internuarvet. Unë them që, që të gjitha këto duhet të shihen pikërisht nën dritën e së vërtetës. Nuk po flas për mijëra fëmijë e të rinj që kapitalizmi i sotëm po i mbyt në detrat e Mesdheut. Nuk po flas për 10 mijë fëmijë që vetëm në vitin 2015 janë trafikuar në Evropë dhe kanë humbur pa gjurmë. Po flas vetëm për fëmijët këtu brenda Republikës së Shqipërisë. Si po kujdesen qeveritë e sotme, antikomuniste, për këta fëmijë?! Shkoni shihni para shkollavet, në orët kur fillon ose mbaron mësimi, si vijnë prindët për t'i shoqëruar vogëlushët e vet, sepse s'ka siguri! Shihni ku përfundojnë qindra vajza të reja shkollare! Nëpër motele përfundojnë! Shihni qindra fëmijë të tjerë si lypin rrugëvet! Në shumë shkolla qytetesh, për të mos ngrirë nga të ftohtit, fëmijët marrin, o batanie, o ngrohëse elektrike me vete! Shkoni e shihni nëpër fshatra: Fëmijët tanë, gjysmë të uritur, s'kanë një urë për të kaluar lumin dhe varen nëpër tela, me çantat e tyre të rënda, plot me libra shpeshherë çorientues!] (Gj.D.)

"***Sa i përket stazhit në prodhim, atë duhet ta bëjnë edhe nxënësit, edhe studentët, pas mbarimit të shkollës, për aq kohë sa është caktuar***." (Vep.50, f.102)

[Në fusnotë, në po atë faqe, është shënuar: "***Stazhi njëvjeçar në punë, pas mbarimit të shkollës së mesme dhe universitetit, u hoq***." Unë, në vitin 1982, duke i parë në terren këta probleme, të cilët nuk kishin të

bënin vetëm me të ardhshmen e Kombit tonë, por parimisht edhe me të ardhshmen e krejt njerëzimit, hartova dhe i dërgova Enver Hoxhës një elaborat, të cilin lexuesi i librit „***Rrnoj edhe unë për me tregue***“ tashmë e ka lexuar… Por punët u rrokullisën aq së prapthi, sa tash s’po dimë: A do të mbushen ndonjëherë me mend njerëzit, apo do të vetazgjësohen në mënyrën më tragjike?!] (Gj.D.)

Më 23 shkurt 1973 lexojmë këto fjalë të Enverit: “***Jo njëherë, po shumë herë më ka qëlluar të bisedoj me nxënës të shkollavet të mesme të arsimit të përgjithshëm dhe me studentë… dhe kam vënë re se nuk njohin lëvizjet e rëndësishme shoqërore e historike të epokavet të ndyshme…, se nuk kanë asnjë fije njohurie… mbi disa shkrimtarë e filozofë që kanë bërë epokë në mendimin njerëzor… A mund të pranohet një gjë e tillë si normale?!. Sigurisht, faj kanë pedagogët për këtë, por nxënësit dhe studentët tanë vallë nuk janë fajtorë***?!“ (Vep.50, f.223)

[Janë fajtorë që të gjithë, por fajtori apo i merituari më i madh është SECILI PËR VETE. Në praktikën time si mësimdhënës unë kam përdorur metodën që po e sjell këtu në formë të shkuruar:

Secili nxënës kish detyrë të lexonte e pakta 20 faqe libër në ditë, çfarëdo libri që t’i pëlqente atij, dhe, mbasi ta mbaronte, duhej detyrimisht të shënonte në një notes të vogël xhepi titullin e librit, sa faqe kish dhe datat kur ka filluar ta lexojë dhe kur e ka përfunduar leximin. Unë herëpas’here ua kërkoja nxënësvet ata blloqe shënimesh, bëja një lloj sondazhi për librat që ata thoshin se i kanë lexuar, vija nënshkrimin tim te shënimet e tyre dhe, atij që e kish realizuar normën 20 faqe në ditë, i vija një notë 10 në regjistër. Në këtë mënyrë, nxënësit e mi arrinin të lexonin më shumë se 6000 faqe në vit dhe për 4 vjet atyre u bëheshin 24 mijë faqe literaturë e lexuar. Ata nxënës që e kanë zbatuar këtë metodë leximi sistematik, kanë arritur të bëhen njerëz me kulturë të gjithanshme

dhe të qëndrueshme. Sot ata i kam: gazetarë, shkrimtarë, deputetë, mjekë të mirë, profesorë, biznesmenë të suksesshëm e deri punonjës në Bankën Botërore.] (Gj.D.)

15 mars 1973: „***Unë propozoj që të rishikohet ligji, ku të përcaktohet shumë më rëndë përgjegjësia e prindërvet të atyre fëmijëve që nuk kanë arritur moshën ligjore dhe që marrin rrugën e vagabondazhit... Mësuesit dhe pedagogët... kanë... përgjegjësi të madhe jo vetëm për edukimin shkollor, por edhe për edukimin jashtëshkollor të nxënësvet dhe të studentëvet të tyre***.“ (Vep.50, f.325)

[Në emisionin „***Fiks fare***“ u trajtua rasti kur një mësuese ka goditur me shpulla disa nxënës, siç thuhet, „***jashtë procesit mësimor***“. Arsyeja: se nxënësit e kanë gjuajtur mësuesen me vezë.

Pyetjet janë të shumta, por e para pyetje do të ish kjo: Ata, le t'i quajmë rutinisht „***nxënës***“, a nuk e gjuajtën mësuesen me vezë „***jashtë procesit mësimor***“?! E dyta: A nuk tregon kjo se, në sistemin e sotëm kapitalist, edukimi i fëmijëvet dhe i njerëzvet në përgjithësi, ka dështuar?!] (Gj.D.)

5 maj 1973: „***Është e drejtë dhe e nevojshme që gjuhët e huaja të studiohen në shkollat tona... Për të kryer mirë detyrën, për t'i mësuar mirë nxënësit e ardhshëm, (studentët) vetë, në radhë të parë, duhet të studiojnë shumë dhe ta njohin mirë gjuhën e huaj për të cilën po përgatiten***.“ (Vep.51, f.15-16)

15 maj 1973: „***Në shkolla dhe në universitet ka pasur dobësi të theksuara si në punën e trupit mësimor, ashtu edhe nga nxënësit e studentët***.“ (Vep.51, f.47) „***Partia dhe kuadrot e rinisë duhet të nxjerrin mësime nga gabimet seriozë që u lejuan të bëhen***.“ (Vep.51, f.48)

[Enveri përpiqej kështu t'i vinte në rrugën e duhur të korrigjimit këto dukuri, por koha tregoi se ishte e pamundur. Njerëzvet, sapo u kish zënë luga lëng, u kish marrë koka erë.] (Gj.D.)

„***Në botën borgjeze bëhen përpjekje (për të gjallëruar lloj-lloj shkollash arti) të panumërta, që lindin si kërpudhat dhe u përngjasin, mendimit reaksionar, sektevet fetarë dhe herezivet që janë zhvilluar gjatë shekujvet... Marksistë-leninistët, ashtu si luftojnë kundër çdo gjëje reaksionare, kundër feve e herezive, duhet të luftojnë edhe ndaj të gjitha këtyre shkollave kaq të rrëzikshme e të dëmshme për edukimin estetik të brezit të ri***." (Vep.51, f.65)

29 maj 1973: „***Kujdes për EDUKIMIN e rinisë shkollore duhet të tregojë edhe shkolla, gjithë personeli mësimor, që nga kopshti deri te shkolla e lartë. Të kufizuarit vetëm në dhënien e njohurivet mësimore, pa i lidhur këto vazhdimisht me EDUKATËN, është një punë krejt e pamjaftueshme***." (Vep.51, f.183) (Fjalët ***edukim*** dhe ***edukatë*** janë theksuar prej meje. Gj.D.)

27 qershor 1973: „***Po duken gjithnjë e më qartë përpjekjet për realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në gjithë punën mësimore-edukative, për zbatimin në unitet të mësimit me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, për revolucionarizimin e metodavet të mësimit e të edukimit***." (Vep.51, f.324)

[Në të vërtetë, sado që të shqetësohej e përpiqej Enveri dhe sado që të përpiqeshin mijëra mësues për ta realizuar atë bosht ideologjik, rrjedha e përgjithshme e EDUKIMIT dhe e VETEDUKIMIT, edhe e kësaj pjese të vogël të njerëzimit që quhej RPSSH, kish marrë rrokullimën. Rrokullima tashmë nuk mund të ndalej.] (Gj.D.)

22 shtator 1973: „***Këtu u tha se ka edhe nxënës që nuk venë në shkolla. Këto janë çështje që kanë të bëjnë pikërisht jo vetëm me nxënësit, me***

familjet e tyre dhe me shoqërinë jashtë shkollës, por drejtpërdrejt e, në radhë të parë, me mësuesit e pedagogët, nga niveli i të cilëvet varet shumë.“ (Vep.52, f.139)

[Do të thosha, nga niveli i MORALIT të tyre, sepse, nga vitet 1990 e këndej, midis mësuesvet dhe pedagogëvet u krijua një kastë e turpshme ryshfeçinjsh dhe të tjerë shkelësish të parimevet pedagogjikë, midis të cilëvet nuk munguan as pedofilët, ndotja më e neveritshme e moralit, jo vetëm pedagogjik, por edhe gjithnjerëzor!] (Gj.D.)

9 nëntor 1973: „***Sot në Gjirokastër ka 8 shkolla të mesme me shkëputje nga puna, 9 pa shkëputje nga puna, si dhe një shkollë të lartë, të cilat ndiqen nga 3300 nxënës dhe mbi 1100 studentë... (Ndërsa) gjatë 16 vjetëvet të ekzistencës së Liceut të Gjirokastrës, u diplomuan vetëm 9 maturantë, (sot) vetëm në këtë vit shkollor shkolla e mesme e arsimit të përgjithshëm ‚Asim Zeneli‘ diplomoi 454 vetë, ose 50 herë më shumë***.“ (Vep.52, f.266)

28 qershor 1974: „***Të parët tanë ëndërronin për një Shqipëri ë lirë, ku populli të mësonte të shkruante gjuhën e tij, të kishte shkollat e veta. Tani kjo ëndërr e tyre është bërë realitet. Shkolla ka deri në skajet më të largët të vendit... Ne kemi ngritur edhe universitetin dhe plot shkolla të larta, për të cilat kishte ëndërruar me aq zjarr Sami Frashëri. Me mijëra studentë studiojnë pa paguar asnjë lloj shpenzimi apo takse për mësimin që u jepet.***“ (Vep.52, f.494)

[Lexo pak më lart shënimin tim! Krejt struktura e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë, u moleps me skota ryshfetmarrësish e ryshfetdhënësish, që nga shefat e drejtorivet arsimore e deri te lloj-lloj pinxhosh me diploma të fituara me ryshfete! U dogjën në zjarr ëndrrat e Sami Frashërit!] (Gj.D.)

3 tetor 1974: „***Kultura dhe arsimi, që kanë marrë një hov të madh e të paparë, janë ngritur mbi baza shkencore marksiste-leniniste. Nga shkollat tona është krijuar një armatë e tërë kuadrosh të dalë nga gjiri i popullit. Ne kemi tani mjaft talente të shquar në shkencë, në teknikë dhe në art***.“ (Vep.53, f.144)

[Ishte e vërtetë, por ajo inteligjencë e shkëlqyer, u shkërmoq e u shpërbë me dhimbje e me lemeri në procesin shkatërrimtar të restaurimit!] (Gj.D.)

20 dhjetor 1974: „***Do të jetë gabim që pedagogët tanë të mos lexojnë libra të huaj, të mos nxjerrin prej tyre konkluzione të drejtë e revolucionarë dhe të mos mbajnë qëndrime kritikë sa herë e shikojnë të nevojshme***.“ (Vep.54, f.44)

Në vazhdim shohim këtë vërejtje: „***Nuk lejohet pa vënë në punimin e vet referimin se i kujt është ai argument apo ide***.“ (Vep.54, f.44)

[Kush tha se Enver Hoxha e pat izoluar shtetin shqiptar?! A kështu izolohet vendi, duke i këshilluar njerëzit që të lexojnë libra të huaj?!] (Gj.D.)

26 mars 1975: „***Flitet... që çështja e përgatitjes ushtarake neglizhohet në shkolla. Mirë që flitet në çdo referat për tre komponentët, po se ç'bëhet me ta, kjo a nuk na intereson?! Atëherë pyesim: Kush do të interesohet, kur nuk interesohet Ministria e Arsimit dhe e Kulurës...? ...E keqja qëndron në fryrjen e aparatevet të ministrivet, jashtë ministrivet, ndër institute e drejtori të përgjithshme. Këtu janë grumbulluar njerëz që i marrin rrogat kot***.“ (Vep.54, f.256)

[Këtu do kërkuar edhe njëri nga shkaqet që dështoi komunizmi: Shfrytëzimi i njeriut prej njeriut u shfaq në formën rrogëmarrjes pa punuar.] (Gj.D.)

21 maj 1975: „***Të përpiqemi që (minoritetit grek) t'i mësojmë gjuhën e re greke në zhvillimin e saj. (Sepse) gjuha greke, si çdo gjuhë tjetër, ka bërë ndryshime të mëdhenj... Pse të mos sillen disa fjalorë të gjuhës së sotme greke apo edhe materiale të tjerë për ata shokë që merren me shkollat dhe me kulturën e minoritetit?***" (Vep.54, f.384)

[Ky ishte tipari humanist dhe internacionalist i Enver Hoxhës! A mund të gjeje në shtetin grek kapitalist, një kryetar partie, një president a një kryeministër, që të thoshte: ***Të përpiqemi që shqiptarëvet të Çamërisë, të Janinës, të Konicës, të Kosturit, të Follorinës dhe arvanitasvet, t'u mësojmë gjuhën shqipe***?!] (Gj.D.)

29 maj 1975: „***Për Thoma Delianën do të thosha se ky nuk po tregohet i aftë për të drejtuar arsimin dhe kulturën... Prandaj mendoj të paralajmërohet seriozisht***." (Vep.54, f.468)

[Më duhet të cek pak me këtë rast atë që Enver Hoxhën e akuzojnë që i ka keqtrajtuar, persekutuar e deri asgjësuar „kriminalisht" ish-bashkëpunëtorët e vet. Është element që kërkon të studiohet me metoda objektive. Ç't'i bënte Enveri Thoma Delianës?! A t'i bënte vërejtje e ta linte aty?! Apo ta shkarkonte pa kurrfarë mase ndëshkimore?!] (Gj.D.)

21 maj 1976: „***Çështjen e tekstevet shkollorë... të mos ia lëmë vetëm një zëvendësministri dhe zëvendësministrat e tjerë të mos interesohen, se tekstet janë si buka, baza e punës për shkollat***." (Vep.57, f.338)

„***Ka akoma tekste që bëjnë shumë fjalë për potencialin ekonomik të Bashkimit Sovjetik, të Ingliterrës dhe të Shteevet të Bashkuar të Amerikës... A thua se neve na u prishka puna sikur të mos dinë nxënësit tanë se cili është potenciali amerikan për derdhjen e çelikut***!" (Vep.57, f.352-353)

1 tetor 1976. „***Ai tjetri që (në shkollë të mesme) ka marrë gjashtën e shtatën, e që e mbaron universitetin natën ose me korrespondencë, në jetën praktike mund të tregohet shumë më i zoti dhe ia kalon atij që ka mmarrë 10***.“ (Vep.58, f.258)

[Kjo vërejtje e Enverit kish shumë rëndësi, pasi një student i dhjetavet mund të ish krejt i pazoti në jetën praktike. Mund të ish skolastik, mendjemadh, i pasinqertë, egoist, po edhe farë somnambuli që s'dinte t'i jepte gomarit ujë. Jeta praktike është ajo që i verifikon dijen dhe aftësinë e një njeriu, por edhe moralin e tij.

...Në kohën e sotme, ndër ne, një mësues i diplomuar, pa marrë parasysh diturinë dhe aftësitë tija, duhet të paguajë nën dorë 5 mijë euro vetëm për t'u futur në punë dhe mbas 3 ose 5 vjetësh, prapë pa marrë parasysh diturinë dhe aftësitë tija profesionale, mund të pushohet nga puna, për t'ia lëshuar vendin një tjetri që i ka bërë gati 5 mijë eurot për nëpunësin punëdhënës.] (Gj.D.)

1 nëntor 1976: „***Vija e Partisë për zhvillimin e arsimit mbi bazën e lidhjes së mësimit me jetën, të përgatitjes së një brezi të ri të kalitur me ideologjinë proletare, të pajisur me dije e me kulturë, të aftë për punë dhe për mbrojtje, po vihet në jetë me konsekuencë dhe po jep rezultate gjithnjë e më të mirë***.“ (Vep.59, f.4)

„***Arsimi dhe kultura e masavet u ngritën në një shkallë më të lartë. Në pesë vjetët e fundit mbaruan shkollat e larta mbi 12 mijë e 500 vetë dhe ato të mesme 72 mijë***.“ (Vep.59, f.33)

„***Në vitin 1980 do të vazhdojnë shkollat e të gjitha kategorivet rreth 730 mijë nxënës e studentë dhe do të përfundojnë shkollat e larta 18 mijë studentë, ndërsa ato të mesme 91 mijë nxënës***.“ (Vep.59, f.37)

„***Ka prej atyre që thonë ‚të studioj e kam të zorshme‘, por ata nuk mendojnë se këto pikëpamje janë të dëmshme dhe bëjnë gabim të madh që flasin e veprojnë kështu... Asnjë nuk duhet të thotë se s'ka kohë për të studiuar.***“ (Vep.59, f.160-161)

Në Kongresin VII të PPSH-së, 1 nëntor 1976, Enver Hoxha foli gjatë e gjërë për problemet e arsimit e kulturës dhe kjo tregonte që ai i shikonte pikërisht këto fusha si faktorë vendimtarë në rritjen ose jo të ekonomisë dhe rrjedhimisht në vazhdimin ose jo të sistemit shoqëror komunist.

14 janar 1977: „***Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, siç e dimë, ka pasë bërë gabime të rëndë, po kështu edhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës. A duhet t'i kontrollojmë ne shkollat dhe në veçanti ato të lartat? Më duket se këtë duhet ta bëjmë doemos.***“ (Vep.60, f.223)

14 shkurt 1977: „***Disa të rinj, që hyjnë në marrëdhënie pune pa e mbaruar shkollën, kanë sjellje jo të mira, nuk janë të disiplinuar... Ata kanë bërë gabim që e kanë lënë shkollën, sepse nuk kishin vullnet për mësim, por që të marrin rrugë të keqe,... kjo nuk ka pse të ngjasë***.“ (Vep.60, f.366)

6 prill 1977: „***Një çështje preokupuese për ne është edhe ajo e nxënësvet që mbarojnë 8-vjeçaren dhe që akoma nuk mund të futen në punë, pse, në bazë të ligjit, u duhen edhe dy vjet të tjerë që të rriten, pastaj të punojnë***.“ (Vep.61, f.134)

21 shtator 1977: „***Shteti dhe shkenca jonë nuk mund të zhvillohen e të përparojnë duke qenë të izoluar nga bota që na rrethon***.“ (Vep.62, f.154)

25 tetor 1977. „***Mjaft fëmijë, të cilët nuk vazhdojnë shkollat e mesme, nuk futen në punë për arsye të moshës dhe disa prej tyre kryejnë akte rrugaçërie. Sipas ligjit, nuk duhet t'i lëmë të punojnë në moshë të***

njomë. Fëmija që ka mbaruar shkollën 8-vjeçare, është 14 vjeç. Puna e rëndë në këtë moshë dëmton shëndetin. Në qoftë se atij në fshat i ngarkohet të ruajë delet, ta zëmë, një punë e tillë nuk e dëmton, por në qoftë se vihet të punojë me bel apo të prashitë, kjo është punë e rëndë për moshën e tij dhe nuk i bën mirë për shëndetin. Sidoqoftë, ky është një problem që duhet ta shohim mirë dhe nga të gjitha anët.“ (Vep.62, f.258)

„***Për arsye se zhvillimi i industrisë sonë duhet të shkojë drejt mekanizimit dhe automatizimit, ... do të ketë njerëz nga qyteti që do të duhet të venë për të punuar në fshat***.“ (Vep.62, f.258)

[Kjo është temë shumë e rëndësishme, jetike për njerëzimin, të cilën kapitalizmi, të paktën ky i sotmi, as që është përpjekur ta vërë në rrugën e zgjidhjes.] (Gj.D.)

20 mars 1978: „***Puna është ajo që të nxjerr në dritë, por puna jep fryte më të mirë, kur bashkohet me diturinë***.“ (Vep.64, f.264)

23 mars 1978: „***Të jesh mësues është një detyrë e shenjtë***“, thotë Enver Hoxha, ndërsa nxënësit i porosit kështu: „***Të dashur nxënës e nxënëse, mësoni me kujdes, zgjëroni dituritë që merrni në shkollë. Mësuesit tuaj kanë eksperiencë më të gjërë nga sa ka libri, prandaj u kërkoni atyre t'jua zgjërojnë mësimet, dituritë... Kështu që, ... kur të dilni në jetë... aftësitë tuaja.. t'i vini në shërbim të atdheut të dashur që të bëhet përherë më i zhvilluar e më i lulëzuar***.“ (Vep.64, f.374)

26 prill 1978: „***Tekstet shkollorë të përmirësohen vazhdimisht me afate të caktuar***.“ Zbërthehet mënyra se si duhet të veprohet. Ç'duhet përfshirë në ta nga autorë të kohëvet të mëhershme, si duhen pasqyruar aty të rejat e shkencës dhe në ç'afate duhet bërë rinovimi i tyre. „***Tekstet, si rregull, nuk mund të ndryshohen çdo vit, bile as çdo 3-4 vjet***.“ (Vep.66, f.107)

„***Ai që ka mbaruar universitetin, kur jep historinë ose matematikën në shkollën e mesme, të ketë parasysh jo vetëm përvojën tonë, po edhe atë botërore***.“ (Vep.66, f.107)

„***Dua të di se si e shfrytëzojnë literaturën e huaj studentët. Apo ata kufizohen vetëm me tekstet?***“ (Vep.66, f.110)

28 prill 1978: „***Në shkollat e rrethevet të ndryshëm është mirë të bëhen albume me koleksione nga flora e secilit rreth. Nëpërmjet këtyre të njhen pionierët me bimët, insektet etj. që kanë në rrethin e tyre***.“ (Vep.66, f.150)

[Me kaq sa u citua këtu, a mund të themi që Enver Hoxha ka qenë një diktator i pamëshirshëm e aq më tepër, një „kriminel“, siç e kanë quajtur restauruesit e zellshëm të kapitalizmit në vendin tonë?! Ka me qindra faqe, të shkruara me dorën e tij, të folura me gojën e tij, ku është shprehur me gjithë forcën e mendjes dhe të shpirtit të një udhëheqësi, kujdesi dhe dashuria për fëmijët dhe për të rinjtë. Kombi shqiptar nuk mund të pranojë që vepra e këtij njeriu të madh të mos studiohet e aq më tepër të mohohet, sepse ashtu kërkojnë disa grupe, shtresa apo qarqe të caktuar të botës së jashtme. Enver Hoxha do të zërë vendin që i takon në historinë e Kombit Shqiptar dhe do të vijë një kohë që ai të pranohet edhe në shkallë botërore, natyrisht, jo duke e rivendosur sistemin që ndërtuan ai dhe bashkëkohësit e tij, por duke njohur e pranuar punët që ata i bënë mirë. Në Shqipëri askush nuk ka punuar më shumë e më mirë se Enver Hoxha për shkollimin e shqiptarëvet.] (Gj.D.)

Gjokë Dabaj - Durrës, mars 2017